



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL<sup>1</sup>

*(I përmbledhur)*

Tiranë, më 21.09.2019, ora 10.00

**Drejton mbledhjen**

**Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

#### **Rendi i Ditës :**

*1. Diskutimi dhe miratimi i Listave Përfundimtare të Renditjes së Kandidaturave për 4 vende vakante në Gjykatën Kushtetuese, si edhe i raporteve përkatës të kësaj renditjeje.*

*2. Shpallja e fillimit të procedurës së verifikimit të kandidaturave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019, si edhe zhvillimi i procedurës së shortit për përcaktimin e relatorit të këtij vendi vakant.*

*3. Diskutim për ecurinë e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe numrin e kandidatëve të mbetur për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr.10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.*

#### **Marrin pjesë :**

- |                     |                     |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani   | (kryetar)           |
| 2. Vitore Tusha     | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku       | (anëtare)           |
| 4. Fatri Islamaj    | (anëtar)            |
| 5. Eriol Roshi      | (anëtar)            |
| 6. Fatjona Memçaj   | (anëtare)           |
| 7. Margarita Buhali | (anëtare)           |

---

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:**

1. Erinda Ballanca, përfaqësuese e Avokatit të Popullit.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr.115/2016:**

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

**HAPET MBLEDHJA**

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, deklaroi të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

**Ardian Dvorani** lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

*Diskutimi dhe miratimi i Listave Përfundimtare të Renditjes së Kandidaturave për 4 vende vakante në Gjykatën Kushtetuese, si edhe i raporteve përkatës të kësaj renditjeje.*

*Shpallja e fillimit të procedurës së verifikimit të kandidaturave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019, si edhe zhvillimi i procedurës së shortit për përcaktimin e relatorit të këtij vendi vakant.*

*Diskutim për ecurinë e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe numrin e kandidatëve të mbetur për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr.10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

**Anëtarët e Këshillit** miratojnë rendin e ditës së programuar.

**Këshilli vijon mbledhjen** me pikën e parë të rendit të ditës.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** informon se pika e parë e rendit të ditës, është diskutimi dhe miratimi i Listave Përfundimtare të Renditjes së Kandidaturave për katër vende vakante në Gjykatën Kushtetuese, si edhe i raporteve përkatës të kësaj renditjeje. Mund ta iniciojmë këtë edhe me një diskutim sepse Avokatja e Popullit ka dërguar një shkresë, të cilën sigurisht që ajo do ta arsyetojë në mënyrë të përmbledhur vetë, por që parashtron shqetësimin që Këshilli në datën 9 shtator e ka njoftuar publikisht rezultatin e pikëzimit për secilin kandidat, rezultatet paraprake të pikëzimit për secilin kandidat. Ndërkohë që nuk ka pasur një njoftim për një mbledhje që ka të bëjë me këtë moment, pra me vlerësimin e kështu me radhë.

Në këtë mbledhje të sorme, në zbatim të ligjit, meqënëse ligji parashikon që kur përfundon procedura e vlerësimit dhe Këshilli ka marrë vendim për vlerësimin dhe pikëzimin e secilit prej kandidatëve, hapi tjetër është thirrja e mbledhjes për të miratuar listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve. Edhe me aktet tona, një nga qëllimet e mbledhjes është edhe verifikimi i saktësisë aritmetike, sepse mund të ketë edhe gabime, dhe në varësi të pikëzimit miratohet lista përfundimtare e renditjes për secilin vend vakant. Pasi bëhet ky miratim, shqyrtohet dhe miratohet edhe një raport arsyetues, siç thotë ligji, lidhur me renditjen e kandidatëve. Sigurisht që ligjet kanë gjuhë të ndryshme dhe qasje të ndryshme lidhur me këtë moment të diskutimeve për vendimarrjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Janë përgatitur dhe projekt-vendimi për listën përfundimtare të renditjes për secilin vend vakant, po kështu edhe një projekt-raport i renditjes. Nëse më lejoni fare shkurt, sepse pastaj mund edhe ta diskutojme, nëse shikojmë të dy ligjet flasin për një raport të arsyetuar....

*Erinda Ballanca* ndërhyt dhe shtron pyetjen se cilat janë dy ligjet?

**Ardian Dvorani**, në përgjigje të pyetjes dhe në vijim të parashtimit shprehet se janë ligji për Gjykatën Kushtetuese dhe ligji për Organet e Qeverisjes. Ligji i posaçëm, që është ligji për Gjykatën Kushtetuese, ka një qasje pak më të koncentruar. Por ashtu si e lexoj unë, mendoj që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi do të shqyrtonte kushtet e për lejimin ose jo të kandidimit, do të shqyrtonte pastaj dokumentacionin dhe do të bënte vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve. Madje ai ligji nuk flet as për pikëzimin etj., pra nuk jep detaje më të hollësishme. Ndërkohë që ligji për Organet e Qeverisjes, përveçse flet që Këshilli bën vlerësimin, renditjen, gjithashtu në disa dispozita më përpara, duhet të jetë neni 229, tani mundohem ta kujtoj si numër sepse nuk e kam përpara në këtë moment, aty parashikohet që Këshilli miraton akte, që ne i quajmë vendime, të arsyetuara, për verifikimin e kandidaturës, pra për lejimin ose ndalimin e kandidimit, miraton akte të arsyetuara të vlerësimit dhe pikëzimit për secilin kandidat, dhe ne jemi para një situatë të tillë. Pra raporti i arsyetuar si do të konceptohet? Do të konceptohet si një dokument i cili duhet të përmbajë arsyetimin se pse u lejua kandidimi i atyre që janë në renditje dhe pse u vlerësuan sipas kriterëve me pikët e caktuara, pra për secilin, apo duke qënë se tashmë kemi këto dy ligje, të cilat nuk e kanë të qartë sipas meje zgjidhjen sipas mënyrës sesi janë hartuar gjithsecili prej tyre, do të kemi një raport që shoqëron renditjen, i cili të jetë më i përmbledhur, ku të përshkruajmë atë çfarë ka ndodhur dhe ti bashkëlidhim të arsyetuara aktet mbi bazën e të cilave secili nga kandidatët e renditur është lejuar të kandidojë, si dhe aktin mbi bazën e të cilit secili nga kandidatët është vlerësuar me ato pikë për të cilat rezulton në listën përfundimtare të renditjes. Projektraporti është përgatitur me logjikën e dytë. Mund ta bëjmë edhe ndryshe, pra që të marrim secilin

kandidat dhe të kopjojmë, ndoshta në mënyre integrale, gjithë arsyetimin tonë pse u lejua të kandidoj njëri prej kandidatëve dhe pastaj të kopjonim nga vendimi i vlerësimit dhe pikëzimit pse u vlerësua në total me aq pikë dhe me një sasi pikësh për secilin kriter. Sigurisht do të dilte një vendim voluminoz, por që gjithsesi do të ishte i përmbledhur. Ndërkohë që i gjithë arsyetimi, sipas meje, është rast ezaurues për lejimin e kandidimit, edhe për vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat, është në aktet përkatëse të verifikimit dhe vlerësimit. Kemi optuar për variantin e dytë. Kjo ishte më shumë për ta prezantuar se pse projektraporti i renditjes përshembull, se nuk besoj se keni ndonjë problem me vendimin për listën përfundimtare, sepse aty thjesht verifikohet saktësia matematikore dhe vendoset renditja, pra pse raporti renditjes është bërë në këtë formë shumë më të përmbledhur dhe me metodën e referencës tek aktet përkatëse të secilit kandidat të renditur.

E dyta që doja të thoja, doja t'ju kujtoja që në muajin gusht kur përfunduam procedurën e verifikimit të kandidatëve, të fundit kandidat, ne vendosëm fillimin e procedurës së vlerësimit. Gjatë muajit gusht kur ka qenë pushim gjyqësor për sistemin, zyra e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ka qenë e hapur dhe anëtarët e Këshillit, individualisht apo në takime, kanë punuar gjatë periudhës së gushtit me dokumentacionin, një punë e vështirë në fakt për tu shqyrtuar gjithë ato dokumenta për efekt të vlerësimit. Dhe të paktën unë po flas për veten time, në momentin që ne praktikisht ishim gati për të bërë renditjen dhe pikëzimin, Gjykata Administrative e Apelit, në mos gaboj ka qenë data 22, dha një vendim për znj. Zhaklina Peto. Kështu që për këtë arsye ne edhe pse ishim në proces vlerësimi, pra praktikisht për të shpallur vendimin, aktin e vlerësimit për secilin kandidat, ne për shkak të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit e ndërpreëm dhe u morëm me pjesën që kishte të bënte me rishqyrtimin e rastit të zonjës Zhaklina Peto. Në datën 9 shtator u përmbyll ky proces, pra Këshilli vendosi ndalimin e kandidimit për të dyja vakancat. Kështu që në takimin tonë, sepse ne të mbledhur ishim për efekt të vlerësimit, në takimin tonë të nesërm meqenëse praktikisht anëtarët shprehen se ishin gati për të dhënë qëndrimet tona lidhur me vlerësimin e kriterëve ligjore për secilin kandidat dhe pikët përkatëse, kemi bërë dhe këtë veprim. Arsyetuam se pse, si, qysh, secili prej nesh individualisht, dhe kjo është e dokumentuar, jep një numër të caktuar pikësh për secilin kriter, për secilin kandidat dhe në fund fare ne nxorëm dhe rezultatin. Anëtarët e Këshillit në fund të bisedimit vlerësuan, edhe pse nuk e kishim detyrim, duhet ta theksoj këtë, edhe kolegët mund ta konfirmojnë, por në fund të fundit anëtarët e Këshillit vlerësuan, pjesa më e madhe, që meqenëse i kemi nxjerrë pikët, pa bërë këtë mbledhje të sotme, ne mundet ta bëjmë publike. Meqenëse shumica e anëtarëve e mendonin se duhet ta bënim këtë publikim paraprak, ne e bëmë këtë publikim paraprak. Por

kjo nuk është një publikim që e formalizon renditjen. Formalizimi i renditjes dhe saktësia e pikëve përfundimtare bëhet në mbledhjen e sotme. Ky është historiku i asaj sesi u zhvillua.

Pra, nuk ka pasur nevojë që të bënim një mbledhje tjetër pas datës 9 shtator për efekte të vlerësimit të kandidatëve sepse ne ishim në proces vlerësimi. Anëtarët mund të shprehen vetë. Praktikisht ne e kishim përmbyllur, unë personalisht nuk kisha më nevojë për të studiuar dokumentet dhe për këtë arsye nuk ka pasur mbledhje tjetër. E para nuk kishim asnjë pengesë ligjore, kështu që të nesërmen e përmbyllëm vendimmarrjen tonë për këtë moment. Vendimet e vlerësimit praktikisht pothuajse kanë mbaruar dhe janë në fazën e redaktimit, të cilat gjithashtu janë shumë voluminoze dhe shoqërohen me tabelat për secilin kandidat nga secili anëtar, për pikët që ka dhënë. Ka edhe një dokument tjetër që është individual i secilit anëtar, për pikët që ka dhënë për secilin kriter. Pra është gjithshka e dokumentuar se si janë këto pikë dhe që nuk e di, pastaj do ta vendosim edhe këtu, sepse është një procedurë që e bëjmë ne për herë të parë, nuk është se mund të imagjinonim detajet se çfarë akte do të kishte bashkëlidhur akti vlerësimit. Por për efekt të të qenit transparent me mënyren se si është arritur kjo vendimmarrje do të ketë edhe disa dokumenta të cilat ne do ti bëjmë në këtë mënyrë. Këtë e kisha për të bërë një prezantim të mënyrës se si kemi ardhur në diskutim dhe vendimmarrje për mbledhjen e sotme.

Janë 4 vende vakante për të cilat ne kemi të drejtën dhe detyrimin që të miratojmë listën përfundimtare, raportet dhe, pas kësaj, të përcjellim në organet e emërtesës këto lista dhe raporte bashkë me dokumentacionin e plotë. Në rend diskutimi së pari do të jetë miratimi i listës dhe pas asaj dhe i raportit. Por kjo nuk ka rëndësi sepse mund ti bëjmë edhe të dyja të lidhura me njëra tjetrën.

Një gjë mund ta them paraprakisht, për efekt të saktësisë matematikore, kur kemi miratuar pikëzimin total të secilit kandidat ne kemi bërë një tabelë, e cila është e nënshkruar dhe nga të gjithë anëtarët dhe për efekt të saktësisë aritmetike, nga verifikimi që është bërë, ka lëvizje minimale që vjen për shkak të mënyrës se si i bëjmë pikët që edhe kur u nxorr rezultati paraprak, në çdo rast nuk do të ndikonin sepse bëhet fjalë për të qindë-tat dhe të mijë-tat pas zeros, pra pas pikëve të plota. Duke qënë se ishte bërë me metodën horizontale, pra të nxjerrjes së mesatares për çdo kriter dhe mbledhjes dhe pjestimit për 7 (shtatë), duke qënë se matematikisht metoda edhe më e saktë është mbledhja vertikale për secilin kandidat dhe pastaj mbledhja e totalit të pikëve të dhëna, ka lëvizje milimetrike në rastin e kandidatës së parë nga 610 që është pas zeros shkon në 640. Në rastin e një kandidateje nga 999 bëhet 0, pra rrumbullakoset, pra leviz me 1/1000. Janë gjëra fare të vogla në aspektin matematikor. Sepse dhe kur po bëheshin, një moment u shqetësova sepse s'jemi të profesionit, nuk jemi

matematicien, por kuptova që arsyeja është sepse pas shifrës së tretë pas zeros ka dhe shifra të tjera të cilat kur mbledhen mund të shkojnë në 1/1000 në 1/100, të cilat nëse do të kishin rëndësi patjetër që do të ishin përcaktuese. Por në fakt nuk kanë efekt fare në renditjen e kandidatit. Këto kisha për të thënë paraprakisht. Unë mendoj që ta bëjmë në përgjithësi diskutimin për mënyrën sesi kemi proceduar dhe do të vendosim sepse dokumentet janë hartuar me të njëjtën metodë, me të njëjtën logjikë dhe pastaj miratimin një për një e bëjmë në fund.

*Anëtarët e Këshillit* vijojnë me diskutimin lidhur me mënyrën se si është proceduar për vlerësimin e kandidatëve dhe pikëzimin e meritave të tyre, të shpalluara publikisht në formën e një rezultati paraprak. Në këtë fazë të diskutimit anëtarët e Këshillit dakordësohen me parashtrimin e kryetarit për faktet dhe mënyrën se si u procedura deri në pikëzimin e kandidatëve, me motivet për publikimin e tij dhe me detyrimin për të finalizuar procesin me vendimet që merren në mbledhjen e sotme. Në tërësi anëtarët kanë qëndrimin se, ashtu sikurse po punohet për përfundimin dhe redaktimin e arsyetimit të vendimeve të vlerësimit pikëzimi i kandidatëve është realizuar për secilin individualisht dhe për secilin kriter ligjor vlerësimi. Ky pikëzim do të gjejë vend në arsyetimin e hollësishëm përkatës në vendimin e vlerësimit, i cili, duhet të pasqyrojë rezultaten e pikëzimit të përbashkët, ndërsa në rastin e pikëzimeve dhe vlerësimeve dukshëm të ndryshëm, anëtari përkatës do të përgatisë arsyetimin e tij paralel lidhur me këtë vlerësim dukshëm të ndryshëm. Raporti i arsyetuar duhet të reflektojë procedurën e ndjekur në verifikim dhe vlerësim dhe arsyetimin përse ka rezultuar ajo renditje e kandidatëve në vendin vakant. Shumica e anëtarëve kanë mendimin se raporti i arsyetuar të jetë pëmbledhje e procesit dhe rezultateve të tij pa përsëritur aty vendimet e verifikimit dhe vlerësimit dhe që reflekton atë që rezulton nga vendimet individuale të vlerësimit dhe pikëzimit të secilit kandidat, pa i krahasuar aty me njëri-tjetrin dhe ndoshta pa nevojën e një mendimi paralel apo kundër raportit nga një anëtar sepse mund të rezultojë mendim kundër edhe ndaj vetë pikëzimit që ka dhënë po ai anëtar. Qëndrimi tjetër është që vendimet e vlerësimit janë për vlerësimin individual të kandidatit, ndërsa raporti i arsyetuar duhet të jetë njësoj i hollësishëm si edhe vendimet e vlerësimit duke i pasqyruar ato në raporti dhe duke bërë edhe arsyetimin tjetër të krahasimit ndërmjet kandidatëve. Prandaj raporti i arsyetuar të përmbajë një diferencim krahasues midis kandidatëve.

*Erinda Ballanca* kërkon fjalën dhe parashtron se ne bëmë një diskutim paraprakisht për mënyrën se si do të finalizohet puna kaq e gjatë, kaq voluminoze dhe kaq me përgjegjësi që Këshilli ka bërë nga momenti në të cilin janë emëruar anëtarët e deri më tani. Sigurisht, që

ky është momenti në të cilin realisht duhet të kemi një rezultat, shpresoj sa më pozitiv, për të justifikuar, qoftë besimin e qytetarëve në reformën në drejtësi në përgjithësi, ashtu edhe besimin në këtë proces përkatës të vendimmarrjes. Ajo që e përshkon në të gjitha, nga gërma e parë deri në gërmën e fundit, qoftë kompetencat e dhëna sipas ligjit të posaçëm për organet e qeverisjes së drejtësisë, ashtu edhe ligji për Gjykatën Kushtetuese, është arsyetimi, raporti i arsyetuar. Pra, në asnjë rresht nuk thuhet që ka diskrecion në vendimmarrje, por duhet të jap një arsyetim në lidhje me këto vendimmarrje. Pse është kjo? Kjo është në kuptimin e përgjithshëm të asaj që ka qënë fryma e përgjithshme e reformës në drejtësi, që as edhe një organ në mënyrë individuale të mos bëj përzgjedhjen e këtyre personave të cilët do të jenë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të ketë më shumë se një organ për shkak të procedurave që të ndikojnë në kompozimin e gjykatës, por qëllimi është që të zgjidhen kandidatët më të mirë që do të jenë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Unë deri më sot nuk kam parë asnjë akt, dhe e kam ngritur vazhdimisht edhe tek aktet e tjera, nuk kam parë asnjë akt i cili të ketë një arsyetim shterues në lidhje me vendimmarrjet e KED-së. Gjithmonë në këtë organ janë shqyrtuar raporte të cilat kanë listuar veprime proceduriale të kryera nga ky Këshill. Procedura është një mjet për të garantuar vendimmarrjen. Por ama edhe vendimmarrja, edhe në rastet e përjashtimit, kanë pasur në gjykimin tim problematika të cilat edhe ja kam bërë me dije Këshillit. Sigurisht, që ajo është vendimmarrja juaj dhe ju jeni përgjegjes për atë vendimmarrje, padiskutim e dini ju, mendoni se janë të arsyetuara plotësisht. Por ju e dini, ky është qëndrimi dhe mendimi që unë kam.

Vijmë në këtë raport, i cili qoftë në ligj, në ligjin nr.115, qoftë në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, thuhet raport i arsyetuar. Jo për çfarë procedurash kanë ndjekur, që edhe ato sigurisht ne duhet ti themi nga pikëpamja proceduriale, por raport për renditjen. Në këtë raport, që thuhet raporti për renditjen të kandidaturave të lejuara për plotësimin e vendit vakant, nuk ka asnjë arsye, asnjë shkak, asnjë pse ishte kjo renditja pse kjo ishte renditja më e mirë të cilën ju si Këshill po ja paraqisni organeve të emërtesës rast pas rasti. Nuk gjej përveç të tjerave, në këtë renditje, disa detyrime pse Këshilli e ka të pamundur, që këto që janë detyrime ligjore në këtë rast, pra pse Këshilli e ka të pamundur që ti paraqes 2 lista secilit prej organeve të emërtesës përta i përket garantimit dhe zbatimit të nenit 7/a të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Apo pse e ka të pamundur që të paraqesë për secilin prej organeve kandidatura të mjaftueshme për të bërë përzgjedhjen. Ky është një problem tjetër edhe më madhor që ndoshta ne besoj si juve si Këshill do të gjeni një arsyetim. Por ne gjykojmë që, ky raport duhet të jetë i arsyetuar qartësisht për të thënë që nuk ka pasur asnjë mundësi tjetër që ky Këshill t'u krijojë organeve të emërtesës mundësinë për të pasur 3 kandidatura për secilin

pozicion nga jashtë gjyqësorit dhe tre kandidatura për secilin pozicion nga brenda gjyqësorit, për të garantuar, se pastaj kalojmë në zbatimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese që thotë, kur organi emërtesës do të zgjedh pse Erindën dhe jo Bledin, do të thotë se i ka plotësuar detyrimet e veta ligjore që të garantojë balancat, të garantojë gjininë, të garantojë këtë dhe atë në Këshill. Kështu siç po shkon puna, i bie që ne themi s'është problemi jonë është i atij, ai do thotë këto më solli Këshilli dhe i bie që ligji nuk është zbatuar në frymën e vet efektivisht sepse secili prej organeve heq përgjegjësinë e vet dhe thotë unë kaq emra kisha dhe kaq të çova. Ai thotë unë këto emra më erdhën e këto çova dhe në fund të ditës qëllimi i ligjvënësit që ky organ duhet të jetë organ i balancuar me persona të cilët duhet të kenë njohuri nga fusha të ndryshme të së drejtës po bëhet vetëm me një kategori të caktuar personash me çfarë po kuptojmë ne nga lista, të cilat na janë sjellë për tu miratuar. Kështu që të paktën do të duhej, gjykoj unë, që në këto raporte të bëhet ky lloj arsytimi se për çfarë arsye nuk ka mundur ky Këshill që t'ja japi mundësinë organeve të emërtesës, qoftë Kuvendit, qoftë Presidencës, që të paraqesi kandidatura siç është në përputhje me ligjin për ti mundësuar ata që më tej të bëjnë këto lloj vendimmarrjesh.

Përsa i përket çështjes tjetër që unë e kam edhe më problematike, që është çështja e transparencës, unë kam pasur probleme me transparencën me Këshillin, këtë e kam trajtuar dhe e kam sqaruar. Ju keni qëndrimin tuaj e unë kam qëndrimin tim. Sigurisht secili do të vazhdojë e do të marrë masat e veta, nëse ka apo s'ka në përputhje me parashikimet ligjore. Ajo që unë sot dëgjova këtu ishte që, secili prej nesh duhet të zbatoj ligjin dhe jo rregulloren. Shumë mirë hajde ta zbatojmë ligjin atëherë. Çfarë veprimtarie ka qënë kjo veprimtari në të cilën është vendosur ky pikëzim? Jashtë mbledhjes apo brenda mbledhjes? Nëse ka qënë jashtë mbledhjes duhet të dokumentohet me një vendim qarkullues, me një diskutim nëpërmjet e-mailit apo me një mbledhje të caktuar. Sepse detyrimi sipas rregullores është që, edhe kur është e thirrur mbledhja, e cila është e miratuar në bazë nenit 10 të rregullores së Këshillit, që në rast se ka një mbledhje e cila do të rri gjatë e mbledhur duhet të njoftohet paraprakisht dhe të njoftohet në këtë mbledhjen që Këshilli do të vazhdojë të rri mbledhur për kaq kohë. Unë sot kam hapur faqen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ku nën këtë zë, nën pikën e vlerësimit, nuk kam gjetur as edhe një dokument të botuar përveç jetëshkrimeve të kandidatëve, të listës së kandidatëve të cilët kanë kaluar fazën e parë dhe kjo listë nuk është vetëm për procedurat për Gjykatën Kushtetuese por edhe për ILD - në, pra një listë me të tërë emrat e të tërë personave të cilët janë lejuar për të vijuar fazën e dytë në secilën prej funksioneve që ky Këshill është thirrur për të ushtruar, pra qoftë për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, qoftë për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Dhe brenda secilës prej vendeve,



vendime të KED-së për fillimin procedurës së vlerësimit është bosh, vendime për vlerësimet e kandidatëve është bosh, vendime dhe renditja e kandidatëve është bosh, procesverbale të mbledhjeve është bosh. Nuk ka as edhe një dokument të publikuar sot në datën 21 shtator 2019 në mëngjes, para se të bëhej mbledhja e këtij Këshilli. Kështu që në këto kushte, unë nuk shoh as edhe një thirrje të ndonjë hershme të ndonjë mbledhje të Këshillit në të cilën, kryetari, në përputhje me nenin 10, të ketë thënë kjo mbledhje thirret për të bërë këtë veprim dhe ne do të vazhdojmë të jemi të mbledhur deri në përfundim. Ndoshta e kam unë gabim, nëqoftë se kjo do të ishte do të ishte këtu tek njoftimet që duhet të ishin në faqen zyrtare, sepse s'është e thënë që ju të na komunikoni çdo gjë. Por ama duhet të kemi dijeni dhe në mos nuk na e keni komunikuar s'e keni quajtur të arsyeshme. Na keni bërë shumë komunikime dhe ne e vlerësojmë këtë, por kur s'e keni quajtur të arsyeshme unë prap së prap them s'ka lidhje të komunikohem unë drejtpërsëdrejti domosdoshmërisht kur kjo gjë është publike. Pra nëse një gjë është publike qartësisht unë njoftohem edhe aty. Nëse një gjë më dërgohet mua në mënyrë të posaçme për shkak të detyrimit që ligji përcakton, për juve është detyrim për mua është e drejtë, Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhje dhe veprimtari, unë sigurisht mendoj që ju duhet ta bëni. Nëse ju gjykoni që mund të nxirrni akte nënligjore ku këtë gjë mund ta kufizoni, kjo është gjithsesi përsëri vlerësimi dhe vullneti juaj. Thelbësore në kuptim të nenit 229 është që, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike, të bazuar në merita, me vendim miraton rregulla të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve duke përfshirë dhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit, të shkuarës profesionale, etj. Më tej në të njëjtën pikë thuhet, në përfundim të procesit të verifikimeve, thotë ligji, sipas pikës 4 të këtij neni, Këshilli interviston kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore dhe bën renditje e tyre sipas kriterëve të parashikuara në nenin 240 të këtij ligji dhe harton një raport, ku e arsyeton këtë renditje. Pra edhe ligji e kërkon arsyetimin për renditjen, përveçse arsyetimit për vendimmarrjen për secilin prej individëve. Arsyetimi mund të jetë një gjë e thjeshtë siç mund të thuhet shkakun pse është kjo renditje sepse ky ishte konkluzioni i pikëve. Nga ana tjetër unë mendoj që Këshilli mund të kishte çuar edhe një renditje tjetër për të garantuar p.sh, pjesmarrjen e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, pjesmarrjen e grave në Gjykatën Kushtetuese, pjesmarrjen e burrave në Gjykatën Kushtetuese, pjesmarrjen e juristëve, po mund ta thoshte, por ama për të garantuar këtë pjesmarrje ne të bëjmë një, dy, tre....

*Ardian Dvorani* ndërhyr dhe sqaron se vetëm një burrë ka në lista.

**Erinda Ballanca** vijon parashtrimin duke u shprehur se jam dakort që një burrë ka në lista, por po them që ndoshta a duhet të ketë ndonjë gjyqtar këtu në gjykatë apo sduhet të ketë fare?....

**Vitore Tusha** ndërhyt dhe sqaron se ju duhet të ftoni më shumë që të aplikojnë.

**Erinda Ballanca** vijon parashtrimin duke u shprehur se pse ta ftoj unë? Unë do ta ftoj? Unë sigurisht që mund ti ftoj, por duhet ti ftojmë të gjithë...

**Vitore Tusha** ndërhyt dhe sqaron se kur publikohet një vakancë nga organi, ftesa është zyrtare. Nuk mund të na thuash ne se pse nuk aplikojnë njerëzit.

**Erinda Ballanca** vijon parashtrimin duke u shprehur se nuk thashë unë këtë. Unë thashë që ne duhet të arsyetojmë renditjen. Nuk po them pse nuk aplikojnë njerëzit, skam pse ta them këtë gjë, por po them që Këshilli, në gjykimin tim mund të bëjë një renditje që për këtë emërtesë do të çoj këto emra për këto shkaqe. Është një fakt i njohur tani sot, tani që ne e dimë, që e kemi ditur prej kohësh, por sot do të bëhet publik, që ne e kemi të pamundur, ky Këshilli e ka të pamundur, të çoj dy lista në secilin prej organeve të emërtesës. Pra duhet arsyetuar, unë s'e shoh fare këtë, megjithëse kemi cituar detyrimin ligjor që ka për të çuar dy lista, edhe në bazë këtij ligji, edhe në bazë të ligjit tjetër. Problemi tjetër shumë më i madh që unë shikoj tani është se a po paracaktomë neve emrat me këtë tek organet e emërtesës apo nuk po i paracaktomë? Sepse nuk është detyrë në gjykim tim e KED-së ta paracaktomë. Nëqoftë se ne çojmë tre emra në tre pozicione, në të gjitha rastet njësoj, i bie që nuk ka se çfarë të ndodhi. Në vakancën e dytë do ketë vetëm dy mundësi për të zgjedhur jo tre që ne na e njeh ligji dhe në vakancën e tretë mund të ketë vetëm një...

**Margarita Buhali** ndërhyt dhe sqaron se nuk është thënë që do të dërgohen tre emra kandidatësh. Nëse shikoni listat nuk janë vetëm me tre kandidatë. Do të dërgohet lista me renditjen.

**Erinda Ballanca** vijon parashtrimin duke u shprehur se mundet por kështu janë bërë draftet dhe aty thuhet listë përfundimtare. Nuk ka as argumentim, nuk ka as sqarim pikërisht për këto probleme që nuk janë probleme të vogla. Në gjykimin tim që unë i shikoj si e jashtme e kësaj procedure, për shkak të disa rregulloreve. A ka arritur ky këshill të plotësoj ato kushte? Ato që ka detyrime ligjore të vetat njëherë së pari se raporti këtë duhet të bëjë, dhe t'ja dërgojë për të sqaruar çdo element të punës që ai sigurisht ka bërë. Ky raport është përfundimi i gjithë punës që i çohet organit të emërtesës. Dhe besoj që këtu, kjo punë do të shkoj në duart e secilit prej organeve të emërtesës dhe ata kanë për të thënë, kanë bërë një punë e mirë apo s'kanë bërë një punë e mirë? A e kanë trajtuar çdo element të ligjit në mënyrë shteruese? Ore nuk ka mundur Këshilli të nxjerrë kandidat. E vërtet është kjo.

Këshilli e ka pasur të pamundur që të shpikë kandidat, apo të kundërshtojë ato që janë parashikuar në ligj. Ama Këshilli tregon dhe arsyeton që ky ka qënë shkaku. Unë nuk e gjej tek ky raport, për hir të së vërtetës, i cili sigurisht ka element shumë të mirë përshkruar, por nuk e gjej këtë punë kaq të madhe dhe voluminoze të Këshillit për të bërë atë që duhet të bënte, përgatitjen dhe nxjerrjen e këtyre që duhet të jenë kandidatët, për të mundësuar organeve të emertesës që të zgjedhin midis disa emrave të caktuar, për të pasur kandidatët e Gjykatës Kushtetuese. Sot ka ardhur diskutimi kur do kemi gjykatë? Por çfarë gjykate do kemi asnjë s'po e thotë. Për mua shqetesimi im kryesor është, çfarë gjykate do të kemi tani? Sepse i bie që u bë gjithë kjo punë dhe të gjithë do na shikojnë dhe do thonë çfarë bëtë gjithë këtë punë kaq të madhe për bërjen e ligjit dhe për gjitha të tjerat, kur neve s'po nxjerrim dot dhe nuk po e bëjmë dot gjykatën, dhe nuk po e bëjmë gjykatën në ato kualitete që do duhet që qartësisht ti kishim bërë. Për këtë arsye duhet të shpjegojmë, ka pasur këtë problem ligji, ka pasur numër të kufizuar, domethënë ka pasur ca gjëra që duhet të jenë të arsyetuara në këtë raport. Ky raport duhet të jetë ajo që ju do flisni me publikun. Nuk keni folur asnjëherë për shkaqet që ju i mendoni se janë në ligj, edhe për detyrimet ligjore nuk keni folur asnjëherë. Ama ky raport duhet të tregojë në mënyrë shteruese se cila ka qënë puna që juve keni bërë. Vendimi dhe vetë aktet që ka miratuar Këshilli, thotë që edhe për vendimin e renditjes mund të ketë pakicë. Pra pakica mund të ketë dhe për faktin pse renditen këto 3 emra dhe jo 3 emra të tjerë, dhe thuhet anëtari dhe mendimi i të cilit lidhur me këto akte, në pikën 73-, ka mbetur në pakicë shkruan fjalën kundër. Pra, mund të jetë teorikisht. Unë kam pasur mendimin që pakica ime vjen për shkak se qëndrimi që unë kam pasur ka qënë qartazi i ndryshëm në renditjen e një individi, apo në renditjen e dy individëve, nuk e di, i ndryshëm nga të tjerët. Atëherë, unë jam kundër jo vetëm me pikët përfundimtare, që e kam sqaruar në vendimin për caktimin e disa pikëve, por jam kundër edhe kësaj renditjeje, sepse tek kjo renditje nuk figuron atë që është më e mira për shkak të 1, 2, 3, 5 sipas mendimit të vet, nëse e ka. Sepse kemi shkuar këtu që ka mendim pakice për këtë. Kështu si thoni po thoni i bie s'ka mendim pakice për renditjen, do të jenë të gjithë dakort meqënëse është votuar njëherë në rastin e parë, për vlerësimin.

Përveç të tjerave këtu kemi parashikuar, në pikën 67 të rregullores thuhet, vendimi i vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit i hartuar sipër kësaj pike dhe sipër thotë se si behet ky vlerësim, votohet dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që marrin pjesë në vlerësim. Tani për çfarë bëhet votimi, kur kjo qënka? Bëhet votimi formal për të vërtetuar që këto janë pikët e Erindës, këto janë pikët e Bledit? Apo bëhet për të thënë që unë jam dakort pavarësisht se ky është rezultati, por unë mund të mos jem dakort me këtë vendimmarrje se

kam pasur qëndrim ndryshe. Nëse ka apo jo pozicione për të cilat ka një qëndrim qartësisht shumë të ndryshëm midis anëtarëve, nëse ka, nëse s'ka dhe janë të gjithë që pikët janë pak a shumë këto pikë tregojnë mesataren reale të pikëve të gjithësecilit, i bie që s'ka pasur në asnjë rast vendim ndryshe. Pra edhe këtu vetë, qoftë në nenin 67, qoftë në nenin 73 të rregullores, të 5-ës, tregon që ky Këshill ka marrë vendimin që mund të ketë vendimmarrje kundër të arsyetuara, sigurisht edhe për vendimin individual të secilit prej kandidatëve edhe për renditjen për shkaqe të cilat mund të jenë të ndryshme ose jo, unë nuk e di. Mundet që një kandidat të thotë, unë nuk jam dakort që kjo është renditja sepse kjo renditje nuk reflekton përshembull faktin që në gjykatë duhet të shkojnë persona nga shumë fusha të së drejtes për të garantuar që vendimmarrja të jetë e tillë. Mund të jetë kjo një mënyrë arsyetimi mendoj unë. Sepse detyrimet që janë në ligj janë të shumta, kriteret janë të shumta, kriteret e cilat janë të përcaktuara qoftë në njërin ligj, qoftë në ligjin tjetër. Edhe puna besoj unë e secilit prej anëtarëve është që në vendimmarrje të trajtojë dhe të peshojë ato që janë më të duhurat. Ata mund të thonë që ne mendojmë që kjo lista me unanimitet, mund të thuhet kjo lista është përfundimtare, kjo është lista që plotëson çdo kriter, nuk është se duhet ta paragjykojmë. Por që ka një lloj, ka peshë, ka nevojë për arsyetim dhe unë këtë arsyetim nuk e gjej tek këto akte fare, për hir të së vërtetës, më vonë do ketë dhe akte të tjera. Por pa pasur aktet e arsyetimit duke ju referuar në këtë akt disa vendimeve të arsyetuara që nuk i kemi, unë si kam parë, nuk ekzistojnë në formën e tyre. Se tani akti kur ekziston? Ekziston kur është i përfunduar, është i firmosur nga anëtarët. Sepse sot vendimet nuk janë në faqe, nuk janë as këtu të bashkëlidhura siç edhe pretendohet. Në raport thuhet janë të bashkëlidhura, unë nuk i kam, nuk më erdhën dje, e kuptoj që nuk do të kishin ardhur dje. I kërkova sot kyetarit më dha një kopjen e akteve për sot, edhe për sot nuk janë dhe në fakt relatoi dhe tha që jemi duke i përfunduar. Nuk e di a mundet të miratohen raporti sot me akte bashkëlidhur të cilat nuk janë? Nuk e di, më duket që ka një problem në lidhje me këtë çështje.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën dhe parashtron se faktikisht mua s'më ngelet shumë për të folur se Avokati i Popullit bëri një përshkrim edhe kronologjik, se kështu është ndërtuar dhe vet raporti. Raporti është një përshkrim kronologjik i fakteve, veprimtarisë dhe vlerësimit që ka kryer Këshilli që prej fillimit. Dhe normalisht nga vështrimi që paraprak i kam bërë, unë mendoj se ka vend për plotësim. Unë jam dakort me çfarë parashtron Avokati i Popullit, asnjë presje nuk i heq fjalës së saj. Por më duhet të evidentoj dhe dy tre elemente që kanë rëndësi për Këshillin meqë tashmë ka hyrë në fazën përmbyllëse të vlerësimit të katër kandidaturave për plotësimin e katër vendeve vakante të Gjykatës Kushtetuese, pra gati gjysmës së përbërjes së gjykatës dhe ku po përmbyllet në nëntë muaj një proces verifikues

dhe vlerësues. Që në faqen e parë të këtij raporti, Këshilli evidenton faktin që Këshillet e mëparshëm nuk kanë arritur që të ndërtohen në rregull. Është e vërtetë, ndoshta këtu meriton pak edhe më shumë vëmendje ose më shumë arsyetim, ku të thuhet që Këshilli i parë nuk është mbledhur asnjëherë dhe Këshilli i dytë u mbledh një herë la detyrë hartimin e akteve dhe EURALIUS ju përgjigj apo nuk ju përgjigj Këshillit për t'ja dorëzuar nuk e di, por mendoj se kërkon një shpjegim se pse. Pikërisht për shkak të vet si institucion, si Presidenti i Republikës, e ka mbajtur qëndrim e vet sa i takon pse nuk funksionuan këshillat. Por për shkak të asaj problematike që është hasur në vijimësi ne kemi vijuar të qëndrojmë, të jemi prezent në 100 % të mbledhjes së Këshillit. E vërtetë, ky Këshill filloj më datën 15 janar mbledhjen e tij të parë dhe detyra kryesore ishte hartimi i akteve nënligjore për të cilën është punuar vërtet shumë mirë për sa i përket volumit, por për disa çështje ne kemi pasur probleme dhe mendime të ndryshme. Vetë përbërja e Këshillit me 7 (shtatë) anëtar, mendoj se duhet evidentuar që Këshilli është i përbërë nga 7 (shtatë) anëtar, pra nuk është i plotë. Në vlerësimin tonë kjo ka sjell problematik tek Këshilli sepse dhe zëvendësuesit nuk i ka të plotë. Ndonjëherë kur është pasur ndonjë kërkesë për papajtueshmëri apo konflikt interesi, ndoshta Këshilli është vendosur në vështirësi për të marrë një vendim se nuk ka anëtarë zëvendësues. Gjithsesi është jashtë raportit por më duhet ta evidentoj. Në vendimet nr. 4 dhe nr. 5 ne kemi pasur debat të madh, Avokatja e Popullit e përmendi kufizimi i rolit të Avokatit të Popullit, pjesmarrjes së tij në veprimtari. Debat shumë i madhë. Ne kemi mbështetur dhe vazhdojmë të mbështesim që Avokati i Popullit duhet të ishte prezent edhe në atë seancën e datës 10-të që Avokati Popullit thotë nuk e di nëse është mbledhje apo është një vijim i veprimtarisë. Sepse po të shikojmë aktet nënligjore të Këshillit, Avokati i Popullit është i përjashtuar dhe aty dhe nëqoftëse ka vijuar të jetë i mbledhur prap është i përjashtuar, pra është një problem që ka lindur që prej hartimit të akteve dhe që nuk është në frymën e ligjit. Një tjetër problematikë që duhet evidentuar, është sa i takon proces-verbaleve të mbledhjes së Këshillit. Sot jemi në muajin e 9-të të veprimtarisë në mbyllje të tij dhe nuk kemi procesverbale të zbardhura e të miratuara siç e kërkon neni 226, 232, neni 17 pika 1 e vendimit nr. 1 të rregullores. Edhe kjo është një element tjetër që ka ngelur i paplotësuar. Kemi pasur 42 kandidatë, unë mbaj mend që kjo ishte tabela e parë që i është ofruar, 42 kandidatë në plotësimin e 6 vakancave. Gjatë veprimtarisë së Këshillit, pas fillimit në datën 4 (katër) prill apo 5 (pesë) prill të procesit të verifikimit, një pjesë e mirë e kandidatëve kanë paraqitur dorëheqjen dhe kjo mund të ketë ardhur siç kanë parashtruar ata, nuk plotësonin dot kohën për të plotësuar deklaratat e tyre. Është fakt që, ashtu siç tha dhe Avokati i Popullit, Këshilli do të duket se nuk do të mundet të plotësoj dot detyrimin e nenit 7/b të ligjit nr.8577

për hartimin e dy listave. Edhe kjo meriton të arsyetohet qartë, nuk mundet apo nuk mund të zbatohet, duhet të gjej një arsyetim më të qartë. Këshilli ka pasur, ose të paktën ne si institucion kemi vërejtur që gjatë procesit të shqyrtimeve gjyqësore në Gjykatën Administrative, në dy proçese ku kemi qënë të thirrur palë persona të tretë, Sinan Tafaj dhe Zhaklina Peto, njoftimet dhe mosnjoftimet e relacioneve, arsyetime të ndryshme të gjykatës për secilin rast. Në njërin rast, tek z.Sinan Tafaj ndodhte që shkelja është konsumuar nga Këshilli por nuk është e atij niveli që të cënonte rezultatin. Në rastin tjetër shkelja është e rëndë dhe ka cënuar rezultatin dhe e ka rikthyer këtu. Z. Sinan Tafaj ka thënë jam njoftuar për relacionin. Znj. Zhaklina Peto ka thënë nuk jam njoftuar për relacionin, këto dallime kisha midis tyre dhe kjo solli si shkak rikthimin e çështjes në këshill. Gjatë rikthimit të çështjes në këshill, edhe ne si institucion, përderisa kemi qënë persona të tretë, kemi mbajtur një qëndrim që në atë proçes gjyqësor kemi qënë në favor të kandidatit. Kemi thënë po, evidentohet se ka shkelje, mbështesim padinë e ngritur, për tu rikthyer në Këshill për plotësimin e gjithë mangësive proçeduriale. Biles kemi kaluar dhe më tej, unë perfaqesuesi i Presidentit por dhe me shkresë është kërkuar që ky vlerësim verifikues për këtë kandidat të kryhet nga organi që ka kryer raportin fillestar, ishte ILDKPI-ja, për të shmangur çdo lloj mendësie që Këshilli ka njëanshmëri, siç e kërkonte kandidati. Edhe kjo nuk është plotësuar. Në këtë shkresë ne kemi përmendur edhe faktin që inkurajojmë Këshillin që të bëj listimin e kandidatëve në mënyrë që organet e emërtesës të zgjedhin sipas radhës ndërmjet 3 kandidatëve që duhet të jenë se sbën të listuar, minimumi se sbën 3, sepse këtë e dikton Kushtetuta. Me këtë raport unë mendoj se Këshilli kufizon pak, apo ndërhyt pak tek kompetencat e organeve të emërtesës në pjesën fundore të tij. Sepse Kushtetuta flet për kandidatë, tek treshja e parë zgjedh, organi i emërtesës zgjedh në tre kandidatë. Ndërkohë që nëqoftë se do të aplikohet radha e përzgjedhjes, disa prej kandidatëve mundet të marrin statusin i emëruar ose i zgjedhur. Kështu që dhe ky moment shumë i rëndësishëm duhet të jetë në vëmendjen e Këshillit. Pra, jo vetëm miratimin e një raporti shterues, shpjegues, por dhe mënyra sesi do të përcillen tek organet e emërtesës kanë rëndësi të madhe sepse do të vendosen, duket se do të vendosen në një vështirësi. Ku në të njëjtën kohë kanë për të zgjedhur, ku në të njëjtën kohë kanë mundësi të heshtin, me ligj, me Kushtetutë. Pra, duhet llogaritur nga Këshilli dhe ky moment shumë i rëndësishëm. E rëndësishme për ne është që të kemi kandidatë në listat tona, për të zgjedhur, ndër tre të parët. Kështu që, nevojitet plotësimi raportit edhe në këtë drejtim dhe duhet të jetë në vëmendjen e Këshillit.

**Erinda Ballanca** kërkon fjalën dhe parashtron se duhet ta kisha thënë më përpara kur mu dha mundësia për të folur. Pavarësisht sesa i rëndësishëm mund të jetë apo jo, unë besoj

që në një rresht, ajo që tha edhe përfaqësuesi i Presidentit, duhet të thuhet që cila ka qënë realisht pjesëmarrja, se nuk ka asnjë informacion për publikun, kjo është e rëndësishme po dhe për Kuvendin, nëse ne si Avokat i Popullit kemi marrë pjesë në pjesën më të madhe në 90 % me pjesëmarrje, për sa është lejuar dhe sa herë jemi thirrur dhe kemi kontribuar në mënyrë të qënësishme apo nuk kemi kontribuar fare, se edhe Presidentit i Republikës ka qënë prezent me përfaqësuesin e tij në këtë organ. Kjo tregon përgjeshmërinë, mendoj unë, të secilit prej organeve në këtë rast dhe e vërteta është, diçka që unë kam konstatuar, që me përjashtime shumë të vogla ne kemi pasur qëndrime të ndryshme. Qëndrimet e institucionit të Avokatit të Popullit të vëna me shkrim në të gjitha vendimet kanë qënë pothuajse të gjitha në një linjë me linjën e përgjithshme të Këshillit, që tregon se ka pasur një përgjegjshmëri të plotë besoj të institucionit tonë me linjën e përgjithshme të mendimit. Përjashtimet kanë qënë të vogla deri në këtë moment. Unë duke menduar që vendimmarrja është tek juve, pra jeni ju ata që keni vendimarrjen dhe sigurisht në nivel përfaqësimi të sistemit gjyqësor, sigurisht që juve keni një nivel përfaqësimi më të lartë. E vetmja gjë që unë prapë e shikoj që është i vetmi problem i këtij lloj Këshilli, por këtu nuk ka rëndësi për relacionin, është se ky Këshill ka vazhduar të funksionojë më shumë si gjykatë sesa si këshill, kjo për shkak të mënyrës së të qenit besoj të secilit prej anëtarëve, por jemi organ administrativ.

***Këshilli*** ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

## **PJESA E DYTË E MBLEDHJES**

***Mbledhja e Këshillit***, pas pushimit, vijon me diskutimet për pikën e parë të rendit të ditës.

***Anëtarët e Këshillit***, vijojnë diskutimet mes tyre lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me ecurinë e procesit të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve për të katër vendet vakante, për natyrën dhe përmbajtjen e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve, për elementët që duhet të përmbajë raporti i arsyetuar për renditjen. Nga diskutimi anëtarët e Këshillit dakordësohen që kanë respektuar procedurat e vlerësimit dhe pikëzimit të përcaktuara në Igij dhe aktet nënligjore të KED, me përjashtim të afatit 10 ditor për shkakun se nuk mundej të përmbylej në kushtet kur ishte në ankim në shqyrtim pranë gjykatës administrative të apelit dhe që dhënia e vendimit të kësaj gjykate për shfuqizimin e akteve të ndalimit të kandidates Zhaklina Peto e bëri të detyrueshme mosvijimin me procesin nxjerrjes së pikëve derisa të përfundonte rishqyrtimi i kësaj kandidature për lejimin ose ndalimin e kandidimit. Pas ndalimit të kandidimit, Këshilli, i cili sipas ligjit ishte i mbledhur dhe nuk kishte asnjë nevojë

e detyrim të bënte njoftime, menjëherë vijoi punën dhe nxorri pikëzimin e secilit kandidat, rezultat paraprak që u bë edhe publik. Sipas ligjit, së bashku me finalizimin e vendimeve të arsyetuara të vlerësimit dhe pikëzimit, verifikimi i saktësisë aritmetike të pikëzimit, miratimi i rezultatit përfundimtar, i listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve dhe raporti i arsyetuar për këtë renditje realizohen në mbledhjen e Këshillit, sikurse është kjo e ditës së sotme.

Gjithashtu, anëtarët e Këshillit u dakordësuan që lista përfundimtare e renditjes së kandidatëve të përfshijë të renditur sipas pikëzimit përkatës të gjithë kandidatët e lejuar për vendin vakant, pa u kufizuar kjo listë me paraqitjen e vetëm tre kandidatëve të renditur më lart, që sipas Kushtetutës dhe ligjit do të përzgjidhen nga organet emërtesës. Është përgjegjësi kushtetues e e organeve të emërtesës të interpretojnë dhe zbatojnë drejt Kushtetutën dhe ligjin. Anëtarët u dakordësuan edhe se do të respektojnë rregullin kalimtar të miratuar me aktin nënligjor normativ, vendimin nr. 5/2019 të KED, për dërgimin e një liste të vetme me kandidatët e lejuar gjyqtarë e jogjyqtarë për çdo vend vakant edhe kur është i njëjti organ emërtesë për motivet që janë diskutuar gjatë dhe janë miratuar në mbledhjen e KED kur është miratuar ky akt nënligjor normativ.

Lidhur me rolin e KED për garantimin e numrit të kandidimeve pranë organeve të emërtesës dhe të përzgjedhjes pas verifikimit dhe vlerësimit të profileve të ndryshme të gjyqtarëve të ardhshëm kushtetues, përfshirë gjininë, profilin etj. anëtar kanë qëndrimin se këto janë çështje në kompetencën dhe përgjegjësinë e organeve të emërtesës. Këshilli ka vetëm detyrimin ligjor që të verifikojë sipas ligjit njësoj të gjithë kandidatët dhe sipas ligjit të vlerësojë e pikëzojë me të njëjtat kritere kandidatët e lejuar. Këshilli ka detyrimin ligjor që të vlerësojë individualisht kandidatët sipas meritave përkatëse, nuk e bën renditjen duke i krahasuar ata me njëri-tjetrin por vetëm mbi rezultatin e pikëzimit individual rezulton edhe renditja e tyre. Kjo renditje nuk bëhet nga KED në funksion të motive të tjera. Për të njëjtat arsye Këshilli nuk ka asnjë kompetencë të veprojë ndryshe në rastin kur njëkohësisht në më shumë se një vend vakant janë kandiduar të njëjtët kandidatë, të drejtë të cilën nuk ua ndalon ligji. Edhe në këtë rast Këshilli vlerëson dhe pikëzon individualisht kandidatët dhe mbi këtë rezultat pikësh i rendit ata. Problemet që mund të kenë organet e emërtesës më këtë gjendje nuk zgjidhen nga KED por nga vetë organet e emërtesës. Në raport fotografohet edhe ecuria procedurale e procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, por Këshilli nuk ka kompetencën dhe statusin që të gjykojë se përse ka funksionuar me 7 anëtarë, përse nuk kanë funksionuar këshillat e mëparshëm apo sjelljet dhe qëndrimet e subjekteve të ftuara në lidhur me procedurat e verifikimit dhe renditjes së kandidaturave.



**Erinda Ballanca** merr fjalën gjatë diskutimit mes anëtarëve dhe parashtron se është fakt që aktualisht për shkak të kërkesave të shumta që kanë bërë kandidatët në më shumë se një organ emërtese, të njëjtët persona janë personat që do të paraqiten në më shumë se një organ. Pra për këtë fakt lind pyetja, në momentin që do përzgjedhi Kuvendi nga kjo lista, sa kandidatë i kanë ngelur për të zgjedhur? 2 apo 3? Prandaj na lind, na lind nga çështja e faktit jo nga çështja e parimit. Në qoftë se ne i çojmë një listë me 3 (tre) kandidatë, atëherë ai e do ta zgjedhë nga një ekstra listë? Do të ishte pyetja ime. Në qoftëse Këshilli çon një listë dhe ka një renditje mund të ketë një interpretim tjetër. Kjo është e para. E dyta. Në rregulloren që ju u referuat dhe ku thatë që ne e kemi zgjidhur me një rregull kalimtar faktin që nuk do çojmë 2 (dy) lista por do çojmë 1 (një) listë, atëherë pikërisht në atë rast e kemi treguar dhe në Këshill kemi vendosur që një parashikim ligjor të jetë i ndryshëm. Si paskemi vendosur ne në atë rast që të ketë një parashikim ligjor të ndryshëm, ashtu mund të na e thotë edhe ne nesër Kuvendi, pushka top ju bëftë vetëmatyre që më sollën vetëm një listë kur ligji e thotë kështu. Pra duhet të ketë një lloj fryme bashkëpunimi konstitucional, mendoj unë, që të gjitha organet njëri me tjetrin të mos i përjashtojnë përgjegjësinë e tyra nga mundësimi që duhet ti bëjnë organit tjetër që ata të ushtrojnë funksionin në kuptim të Kushtetutës. Ne nuk mund të themi, për mua këta janë tre të parët, ai ndaç ta zgjedhi, ndaç mos ta zgjedhi, ndaç ta zbatojë këtë kriter të ligjit, ndaç mos e zbatoj. Duhet të jetë në përgjithësi, dhe prandaj ishin shqetësimet që kisha unë. Pra ne kemi thënë do ketë një listë me rregulloren tonë të brëndshme, e cila nuk është e detyrueshme apo qoftë dhe me aktin tonë të brendshëm që nuk është e detyrueshme për një organ tjetër në rastin konkret, që ti krijojmë ne atij kufizime, qoftë Kuvendit dhe Presidentit. Dhe në këtë shqetësim të madh që ne të gjithë kemi për numrin e vogël të kandidatëve në gjykimin tim, çdo vendimmarrje duhet të jetë e tillë që të krijojë një mundësi sa më të madhe për ta përjashtuar perceptimin që po i caktojmë ne të gjithë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Se s'është kjo kompetenca e këtij Këshilli. Po të ishte e kishte bërë Kushtetuta, thoshte që Gjykata Kushtetuese caktohet nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Por e kanë konsideruar të paduhur, pra një procedurë e cila nuk funksionon apo nuk do të nxirrte anëtarët e duhur në kuptim të Kushtetutës. Prandaj ne gjykoj unë, që çdo klauzolë duhet të interpretohet në mënyrë të përgjithshme, për ta mundësuar tjetrin, ata ne dhe ne ata, për ti mundësuar të gjitha, zbatimin sa më korrekt të ligjit. Sepse është e qartë, gjithëkush do thoshte, nëqoftëse ne çojmë vetëm, Këshilli çon vetëm 3 emra, jo 4, 5, duke bërë renditjen sigurisht, duke bërë renditjen sipas pikëve që ka caktuar të arsyetuar. Edhe rasti i Kuvendit do thotë, pse do zgjedhi Erindën dhe nuk do zgjedhi Erionin? Tek pikët e para. Apo e kundërta pse do zgjedhi Erionin dhe nuk do zgjedhi Erindën? Edhe ai ka arsye për këtë midis tre të parëve.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën gjatë diskutimit mes anëtarëve dhe parashtron se në diskutim u tha që të gjithë janë të interesuar për krijimin e Gjykatës Kushtetuese dhe zgjedhjen e tyre, prandaj Këshilli po vepron në këtë mënyrë. Edhe ne si institucion, Presidenti, jemi të interesuar që kjo gjykatë të jetë sa më shpejtë funksionale. Kemi dërguar dhe një shkresë, e kemi bërë të qartë qëndimin tonë, shumë të qartë biles, e kemi 7 (shtatë) faqe shkresë. Shqetësimi im ishte që, vërtet edhe vetë rendi ditës që është njoftuar thotë, kandidatët të listuar për secilën vakancë, dihet ajo që të gjithë kandidatët, 4 (katër) janë te vakanca jonë te Sokol Berberit, 4 (katër) janë dhe këtu. Ky listim duhet bërë. Ajo që përmenda unë ishte vetëm varianti i fundit, që bën dhe një fotografi i cili do të ekzistoj si fotografi gjatë gjithë 30 (tridhjetë) ditëve. Këtu ishte dallimi. Që ju tashmë e rregulluat dhe po e heqim. Sepse ne, ose çdo organ emërtese kur them ne, se dy janë tashmë Presidenti i parë në radhë, Kuvendi i dyti, do duhet të kenë kandidatë për të zgjedhur. Nëse do të qëndronim në atë variantin e parë, hiq siç ishte vendosur viza, i binte 6 (gjashtë) kandidatë, hiq dy, 4 (katër) për 4 (katër) emërime. Emërime dhe me vështirësi, se zgjidh njërin, bllokohet tjetri.

Vërtet të gjithë anëtarët këtu të Këshillit e kanë veshur kostumin e Këshillit në 1 janar 2019. Ndërsa ne kostumin e organeve të emërtesës kemi nja 18 (tetëmbëdhjetë) a 19 (nëntëmbëdhjetë) muaj që e kemi veshur, e po presim në 19 (nëntëmbëdhjetë) muaj kandidatë dhe ky shqetësim duhet mendohet. Dhe nuk është interesi vetëm i Presidentit që të ketë kandidatët e tij. Presidenti për shkak të natyrës së pozicionit të tij është i interesuar që të kenë të gjithë mundësi të zgjedhin, edhe Kuvendi të zgjedhi rehat, edhe kjo gjykatë të bëhet sa më shpejt funksionale e ti jap disa çështjeve drejtim që po i presin qytetarët, të gjithë, jo vetëm qytetarët. Por unë ngrita dhe një shqetësim dhe për radhën e dërgimit. Edhe kjo është një shqetësim tjetër që duhet ta vlerësoni. Radhën e ka përcaktuar Kushtetuta. Kush e ka investuar Këshillin i pari? Kush e ka kërkuar mbledhjen e Këshillit? Presidenti i Republikës. E shpalli ndërkohë që në 2018, mbledhu, vepron. Sa e shpallëm ne, e shpalli Kuvendi menjëherë. Të njëjtën logjikë. Por duhet të jetë në vëmendjen e Këshillit gjithmonë. Po le ti hyjmë pak vakancave që janë në mars 2019. Janë shpallur dhe një herë më përpara, kur ishin të parakohshme. Kanë dhe këtë indikator. Prapë ne kemi qënë të parët. I pari zgjedh Presidenti thotë Kushtetuta dhe ligji. Rrjedhimisht ka radhë. Presidenti zgjedh i pari, Presidenti ka shpallur vakancën i pari.

**Erinda Ballanca** merr fjalën gjatë diskutimit mes anëtarëve dhe në lidhje me raportin e arsyetuar parashtron se ndoshta do të duhet të benim një shpjegim, një rresht të vogël pse u bë shorti manual. Se kam hallin që nesër kur e lexojnë na thonë pse e bëtë me short manual

kur ligji e thotë që bëhet përjashtimisht manual. S'ë kemi sqaruar, ne e dimë. E them thjesht për çështje proceduriale se kush e lexon mund ta thotë, jo për gjë. Dhe një merak të veçantë kisha unë. E kemi bërë, dhe përsa kohë që Këshilli e ka bërë, është mirë që ta bëj. Është që, kur kemi kërkuar infomacion nga këto institucione të themi ILDKPI, DSIK, KLGJ, KLP, gjithashtu ka kërkuar publikisht mendimin e organizatave të shoqërisë civile, sepse e kemi bërë një gjë të tillë, kemi shpallje dhe jo shpallje. Kjo është më tepër për ta, është më tepër që e kemi bërë, e përsa kohë që e kemi bërë. Dhe kjo në një farë mënyrë e vë dhe shoqërinë civile, se do na thonë ne nesër pse s'na keni kërkuar mendim, dhe në fakt e kemi bërë. Kjo është për gjërat e vogla që e përmirësojnë.

Ju e dini vetë sepse këto janë vetëm shqetësimet dhe mendimet që unë kam, sigurisht vendimmarrjen e keni tuajën. Por kur e them, e them për të mirën e punës, sepse nuk kam asnjë arsye tjetër. Ajo që më dhemb më tepër janë orët, e orët, e orët e kaluara në këtë mbledhje të gjithë ne dhe të mijat, jashtë kësaj sepse kemi lexuar me mijëra faqe gjatë gjithë gushtit pikërisht për këtë gjë, që të vinim të pregatitur qoftë për një pjesë, qoftë për pjesën tjetrën. Jemi përpjekur maksimalisht. Po të isha unë, ju e dini vetë sesi do ta bëni se nuk ka as edhe një lloj rëndësie. Ne duhet ta bëjmë këtë raport sa më pak të atakueshëm nga kushdo sepse unë vendimet s'i kam parë. Ky raport duhet të jetë sa më pak i atakueshëm. Ne mund të mos përfshinim këtu një arsyetim të plotë e të hollësishëm të çdo gjëje për renditjen por një faqe e gjysëm për parimet pse doli kjo renditjen dhe pastaj thoni arsyetim më të hollësishëm mund të gjeni në vendime. Por një lloj arsyetimi duhet të ketë, se këtu s'ka fare arsyetim po vetëm bën një reference, i bie që s'kemi plotësuar kriterin ligjor. Se ligji e thotë qartë, që duhet të jetë raporti i arsyetuar. Pra të gjejmë një rrugë e cila të mos e vërë Këshillin në sytë e dikujt tjetër që e lexon, që shiko kjo gjë nuk është bërë, mendoj unë. E kuptoj qëndrimin që ne nuk duhet të pregatisim, që Këshilli nuk duhet të pregatisë akte të palexueshme. Por nga ana tjetër ligji dy arsyetime parashikon, dhe arsyetim për renditjen dhe një për raportin.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën gjatë diskutimit mes anëtarëve lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e vendimit të vlerësimit dhe pikëzimit dhe parashtron e vërteta është që diferencat e shpërpjestuara në vlerësime sjellin vendimmarrje shumice, veto pezulluese, veto disbalancuese dhe këto shpërpjestime duhet ti gjejmë se s'bën në arsyetim. Konsumatori i këtij produkti do të jenë tre llojesh. Jemi ne si organ emërtese dhe si organ emërteses unë duhet të di se përse një nga anëtarët e Këshillit, dy, apo si e kanë, e kanë votuar me 0 (zero) apo 1 (një) pikë, ndërkohë që kriteri i integritetit e ka 20 (njëzetë), 30 (tridhjetë). Se më bën të dyshoj a duhet ta zgjedh këtë kandidat apo nuk duhet ta zgjedh? A do të duhet ta intervistoj? Kuvendi e interviston në mbledhjen e vet, ne e intervistojmë në godinën tonë dhe

i themi për këtë kriter çfarë ke për të na thënë. Janë domethënëse për organet e emërtesës edhe përshkrimet e shpërpjestuara kur kanë diferenca të kësaj natyre. Do futur brenda në vendim apo shtojcë? Për mua kanë të njëjtën vlerë, po u thanë edhe me footnote shiko arsyetimin e relatorit apo bashkëlidhur vendimit, gjithmonë tek rastet e shpërpjestuara, për mua është integrale në logjikën administrative. Nuk është pjesë e vendimit sepse nuk përfaqëson shumicën, por është një vendim që ka diktuar pikë. Pra, këta të 7 (shtatë) janë këtu në vendim, ky që vlerësoj ndryshe është këtu bashkëlidhur këtij akti, dhe ne njihemi si organ emërtese. Por ka dhe një qëndrim tjetër, i jepet dhe publikut se është dhe kjo. Pse ky këshill e vlerësoj Bledin më lart apo më poshtë se Erinda? Konsumatori i tretë është vetë kandidati, edhe ai do të ketë dyshime pse mora kaq pikë tek ky kriteri.

*Anëtarët e Këshillit*, vijojnë diskutimet mes tyre lidhur me formën dhe strukturën e raportit të arsyetuar, si edhe të strukturës dhe lementëve të përmbatjes së vendimeve për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve të lejuar. Pas diskutimit dhe ballafaqimit të mendimeve të ndryshme, anëtarët e Këshillit dakordësohen që qëllimi i këtij raporti nuk është të krahasojë meritat e kandidatëve me njëri-tjetrin sepse KED ka në kompetencë vetëm të vlerësojë dhe pikëzojë secilin kandidat për meritat individuale. Po kështu, për të mënjeluar përgatitjen e raporteve shumë voluminoze që vështirësojnë njohjen me procesin dhe mund të sjellin mangësi të tjera për shkak të përpjekjes për të përmbledhur arsyetimet eyauruese të vendimeve përkatës, raporti i arsyetuar të përmbajë përshkrimin e përmbledhur të veprimeve dhe procedurave të ndjekura në procedurën e verifikimit të të gjithë kandidatëve, si edhe në procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve të lejuar për kandidim. Meqenëse vendimet e ndalimit ose të lejimit të kandidimit të kandidatëve dhe vendimet për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve të lejuar janë të arsyetuara në mënyrë shumë të hollësishme, si edhe janë të publikuara, në Raportin e arsyetuar për renditjen e kandidatëve do të parashtrohet në parim mënyra se si është arritur në këto vendimmarrja dhe ajo çfarë është vendosur, duke referuar për arsyet e hollësishme të vendimmarrjes në vendimet përkatëse të procedurës së verifikimit dhe atij të vlerësimit për se cilin kandidat.

Në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e vendimeve të vlerësimit dhe pikëzimit, pas diskutimit dhe ballafaqimit të mendimeve të ndryshme, anëtarët e Këshillit dakordësohen që këto vendime të përmbajnë në mënyrë të hollësishme jo vetëm procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidatit por edhe të reflektojnë në arsyetim rezultaten e vlerësimit të përbashkët të anëtarëve e cila tregohet në pikët e caktuara kandidatit për çdo kriter vlerësimi si rezultat i totalit të pikëve të dhëna nga secili anëtar pjesëtuar me numrin e anëtarëve. Nga ana tjetër, pa mohuar mundësinë që në situata ekstreme mund të ketë edhe mendim pakice,

për të garantuar të drejtën dhe detyrimin e secilit anëtar për të arsyetuar mendimin dhe qëndrimin e tij dukshëm të ndryshëm në vlerësim dhe pikëzim, krahasuar me shumicën e anëtarëve ose me rezultatin e përbashët të pikëzimit, këta anëtarë kanë të drejtën të hartojnë mendimin ndryshe të arsyetuar e cila i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e vendimit të vlerësimit të kandidatit. Gjithashtu, jo vetëm për efekt të transparencës, por edhe si pjesë e shfaqjes publike të arsyeve të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, do të bëhen publike edhe tabelat e pikëzimit të kandidatëve për secilin kritret vlerësimi nga secili anëtar dhe që përmban rezultatet përkatëse të pikëzimit në total të të gjithë anëtarëve, të nënshkruar prej tyre, si edhe dokumentin që përmban mënyrën e pikëzimit dhe pikët e dhëna për çdo kriter vlerësimi nga secili anëtar i Këshillit për secilin kandidat, të nënshkruar nga anëtari i Këshillit.

**Anëtarët e Këshillit** në përfundim të këtyre diskutimeve, në mënyrë unanime vendosin të miratojnë listat përfundimtare të renditjes së kandidatëve dhe raportet e arsyetuar për secilin vend vakant me reflektimet e vëretjeve dhe sugjerimeve të kësaj mbledhje. Pas redaktimit përfundimtar, përpara se të nënshkruhen dhe ti dërgohen organeve të emërtesës, këto akte do të qarkullohen për konsultim me postë elektronike. Po kështu miratohet korrektimi në pikët e kandidatëve për shkak të saktësisimit të mbledhjes artimetike. Për rrjedhojë, pa asnjë ndikim në renditjen e kandidatëve, për kandidaten Arta Vorpsi pikëzimi shkon nga 89.610 në 89.642, kandidati Besnik Muci nga 81.926 në 81.928, kandidatja Elsa Toska nga 85.425 në 85.428, kandidatja Fjona Papajorgji nga 88.783 në 88.785, kandidatja Marsida Xhaferllari nga 81.999 bëhet 82.000 dhe kandidatja Regleta Panajoti nga 80.284 në 80.285.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** orienton kalimin në pikën tjetër të rendit të ditës, shpallja e fillimit të procedurës së verifikimit të kandidaturave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019, si edhe zhvillimi i procedurës së shortit për përcaktimin e relatorit të këtij vendi vakant. Ka ardhur dokumentacioni nga Kuvendi për këtë vakancë të parakohshme në Gjykatën Kushtetuese dhe duhet të realizojmë procedurën e shortit. Sigurisht që kemi vetëm 1 (një) vakancë dhe jemi 7 (shtatë) anëtar. Ne nga një diskutim joformal që kemi bërë kur po bënim pikët, thjesht do j'u kujtoj, ne thamë meqënëse zonja Margarita është në proces me vakancën tjetër, mundet që një nga relatorët të përjashtohet sepse ajo e ka tashmë një vakancë në proces dhe të shortohen 6 (gjashtë) anëtarët e tjerë. Pastaj, e dyta, është edhe zonja Memçaj e cila duhet të përjashtohet dhe është miratuar praktikisht akti nga unë sepse i afërmi i saj është njëra nga kandidatet. Kështu që mund të jetë një short mes 5 (pesë) anëtarëve për pozicionin procedural të

relatorit për këtë vend vakant. Do të sugjeroja një gjë, sepse në rregullat që kemi parashikuar kemi thënë që shortohen edhe këshilltarët për vend vakant. Janë 6 (gjashtë) kandidatë, por 2 (dy) janë që janë vendimuar pozitivisht apo negativisht nga ne. Pra 4 (katër) janë të rinj. Në rregullat për shortin kemi thënë edhe një gjë tjetër që, pas shortit për caktimin e relatorit, të shortohen dhe për këshilltarët për vend vakant. Mund ta kishim një rregull plus aty, që përshembull kur ka 1 (një) vakancë, ç'kuptim ka që kemi 4 (katër) këshilltarë dhe shortojmë vetëm njërin nga këshilltarët të punojë me 1 (një) vend vakant, ta zëmë me 20 (njëzetë) kandidatë ndërkohë që kemi 4 (katër) në dispozicion. Mundet që dhe për efekt transparence për të mos pasur ndonjë problem, të bëjmë short edhe me këshilltarët për kandidatët. Pra 3 (tre) këshilltarë, sepse njëra është në proces, i vijmë dhe 4 (katër) kandidatë të tjerë, pra Laureta mund të mos jetë.

*Anëtarët e Këshillit* janë dakord me propozimet e paraqitura nga kryetari.

## **MBYLLET PJESA E DYTË E MBLEDHJES**

*Në PJESËN E TRETË TË MBLEDHJES, realizohen veprimet e shortit për caktimin e anëtarit të Këshillit relator për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019, si edhe për caktimin e këshilltarëve që punojnë secili me aktet për kandidatë në mbështetje të veprimtarisë së anëtarit të Këshillit relator të kësaj vakance.*

*Procesverbali i hedhjes së shortit i bashkëlidhet këtij procesverbal të mbledhjes së Këshillit.*

## **PJESA E KATËRT E MBLEDHJES**

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas përfundimit të procedurës së shortit, njofton kalimin në pikën e fundit të rendit të ditës për diskutimin mbi ecurinë e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe numrin e kandidatëve të mbetur për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr.10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës. Ky diskutim vjen pas vendimeve që Këshilli mori në datën 9 shtator, për ndalimin e kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto për dy vendet vakante dhe tashmë na rikthehet situata në gjëndjen që ishte përpara rreth 1 (një) muaji e gjysëm. Pra na ngelën përsëri 2 (dy) kandidatë për vendin vakant. Ne e patëm një qëndrim herën e kaluar dhe thamë që po e njoftojmë Shkëlqesinë e Tij Presidentin e Republikës që kjo*

është situata, gjithmonë dhe me rezervën që kemi thënë dhe vetë, që nëse nga ankimet na rezultojnë ndryshe ne pastaj mbajmë qëndrimin tonë. Dhe ashtu siç dhe në fakt na ndodhi, që nga ankimet e bëra për shkak se njëra prej tyre u pranua nga gjykata, morëm vendim për ta revokuar dhe për të vijuar procedurën. Tani unë e shtroj për diskutim nëse, sikurse relatori ishte i detyruar ta paraqiste si situatë fakti, nëse do ta përsërisim përsëri të njëjtin njoftim tani apo do të presim derisa ti mbarojnë afatet kandidates. Kandidates i mbarojnë javës tjetër afatet e ankimit. Unë them që e mira e do që më mirë ne e dërgojmë njoftimin dhe pastaj nëse ka një situatë tjetër që na krijohet nga vendimmarrja, nga ankimi i mundshëm i kandidates, apo nga një vendimmarrje e gjykatës, ne pastaj mbajmë qëndrimin tonë. Ndërkohë i japim dhe hapësirë edhe Presidentit që ai ta vlerësojë vetë. Pra ne nuk mund t'ja imponojmë. Fotografia ime me 2 (dy) kandidatë, unë prap i mbetem këtij qëndrimi, nuk më jep mua të drejtën të pres sa të mbarojnë afatet. Unë të njoftoj, pastaj ai e vendos vetëse ç'farë do të bëj.

**Bledar Dervishi** kërkon fjalën dhe shprehet se ruajmë të njëjtin standart. Ju na njoftuat menjëherë dhekeni vendosur brenda këtij afati 5 (pesë) ditor. Na e lini ne në vlerësim do ta rihapim menjëherë apo dhe do presim si ju. Kështu që jemi në këtë qëndrim, mirëpresim njoftimin.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, shpjegon se teksti i projektvendimit është i njëjti, ndryshojnë vetëm datat. E miratojmë?

**Anëtarët e Këshillit** në mënyrë unanime e miratojnë projektvendimin

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, pasi evidenton që këto ishin çështjet e programuara për shqyrtim në rendin e ditës, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

## **MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 13.15**

**Sekretare**

**Kryetari**

**Dorina Dulaj**

**Ardian Dvorani**

**Ermelinda Kadiu**